

LIGJ
Nr. 14/2023

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 296, DATË 8.7.2010,
“PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Kudo në përmbajtjen e ligjit bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Fjalët “sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit” zëvendësohen me fjalët “sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit”.
2. Emërtimet “Ministri i Financave” dhe “Ministria e Financave” zëvendësohen përkatësisht me fjalët “ministri përgjegjës për financat” dhe “ministria përgjegjëse për financat”.
3. Fjalët “struktura përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe kontrollin” zëvendësohen me fjalët “struktura përgjegjëse për menaxhimin financiar, kontrollin dhe kontabilitetin”.
4. Fjalët “veprimtari kontrolli” zëvendësohen me fjalët “aktivitete kontrolli”.

Neni 2

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

a) Pikat 1, 3, 9, 17 dhe 18 ndryshohen si më poshtë:

“1. “Kontrolli i brendshëm financiar publik (KBFP)” është sistemi i kontrollit të brendshëm financiar publik si tërësia e kontroleve të vendosura nga njësitë publike, me qëllim administrimin e suksesshëm për të garantuar se menaxhimi financiar e kontrolli dhe arritja e objektivave të njësive publike janë në përputhje me legjislacionin që rregullon fushën e kontrollit të brendshëm, kërkesat buxhetore, si dhe me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar me transparencë, efektivitet, eficiencë dhe ekonomi. Kontrolli i brendshëm financiar publik përfshin menaxhimin financiar dhe kontrollin, auditimin e brendshëm dhe strukturat përgjegjëse për menaxhimin financiar e kontrollin dhe auditimin e brendshëm.

3. “Kontrolli i brendshëm” është procesi integral i vendosur nga titullari i njësive publike brenda objektivave të tij qeverisë për të ndihmuar në kryerjen e veprimtarive të njësive publike, me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë.

9. “Përgjegjshmëria menaxheriale” është detyrimi i menaxherëve që në kryerjen e veprimtarive dhe marrjen e vendimeve të tyre të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e vendimet e tyre dhe të atyre personave që iu kanë caktuar ose deleguar kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre në përputhje me ligjet në fuqi.

17. “Kontrolle para faktit” janë kontrollet e bëra me qëllim që të garantohet ligjshmëria dhe rregullshmëria e vendimeve. Ato kryhen në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha fazat e procesit, para marrjes së vendimeve.

18. “Kontrolle pas faktit” janë kontrolle të herëpashershme, që ushtrohen pas përfundimit të transaksionit apo veprimtarisë, sipas një plani apo në vijim të një kërkesë.”.

b) Në fjalinë e parë të pikës 26 fjala “informacion” zëvendësohet me fjalën “dokument”.

Neni 3

Pika 16 e nenit 4 shfuqizohet.

Neni 4

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Titullarët e njësive të qeverisjes së përgjithshme caktojnë nëpunësit autorizues sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.”.

2. Shkronjat “a” dhe “b” të pikës 8 ndryshohen si më poshtë:

“a) miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë planet e menaxhimit të trajtimit të risqeve dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave;

b) ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji dhe ngritjen e grupit të menaxhimit të riskut”.

Neni 5

Pika 2/1 e nenit 9 ndryshohet si më poshtë:

- “2/1. Nëpunësi autorizues i njësisë publike, për efekt të menaxhimit financiar dhe kontrollit, cakton nëpunës autorizues të nivelit të dytë drejtuesit e programeve e nënprogrameve të çdo strukture dhe njësie të varësisë direkte për të cilat identifikohet buxhet i veçantë. Në njësitë publike të përshkallëzuara me disa nivele njësish shpenzuese, nëpunësit autorizues caktohen nga organi epror direkt dhe emërtohen sipas nivelit të varësisë.”.

Neni 6

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10

Përgjegjshmëria menaxheriale e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit

1. Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit është nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në përmbushje të përgjegjësisë të tij, nëpunësi autorizues ka të drejtën e delegimit të disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. Përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.”.

Neni 7

Pika 3/1 e nenit 12 ndryshohet si më poshtë:

“3/1. Në njësitë publike të ndërtuara me më shumë se dy nivele varësie, punonjësit e financës në strukturat përgjegjëse për financat, të vendosur në nivelet e poshtme të varësisë, konsiderohen punonjës të deleguar të nëpunësit zbatues të njësisë nga varen. Punonjësit e financës së nivelit të dytë janë punonjësit që kanë përfunduar studimet e ciklit të dytë në shkencat ekonomike ose kanë diplomë universitare të ekuivalentuar me të dhe kanë përvojë 3-vjeçare në profesion. Punonjësit e financës, të vendosur në nivelin e tretë apo më poshtë të varësisë, janë punonjësit që kanë përfunduar të paktën studimet e ciklit të parë në shkencat ekonomike dhe kanë përvojë 1-vjeçare në profesion dhe

raportojnë në mënyrë të dyfishtë te nëpunësi zbatues i njësisë nga varen dhe nëpunësi autorizues përkatës.”.

Neni 8

Pika 4 e nenit 15 ndryshohet si më poshtë:

“4. Delegimi i të drejtave dhe i detyrave, sipas përcaktimeve të këtij ligji, nuk cenon të drejtat e menaxherit dhe nuk e shkarkon atë nga përgjegjësia administrative për realizimin e objektivave, kontrollin e risqeve përkatëse apo për përzgjedhjen e vartësit tek i cili delegohen të drejtat dhe detyrat.”.

Neni 9

Neni 17 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 17 Sinjalizimi

Çdo punonjës, i cili gjatë kryerjes së punës apo në lidhje me zhvillimin e detyrave të tij, vëren fakte të ekzistencës së parregullsive, informon menjëherë në bazë të legjislacionit në fuqi për sinjalizimin dhe sinjalizuesit.”.

Neni 10

Pikat 1 dhe 3 të nenit 18 ndryshohen si më poshtë:

“1. Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme dhe i shoqërisë tregtare, sipas përcaktimeve të nenit 3 të këtij ligji, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë së qeverisjes së përgjithshme që mbulon për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual. Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme zbaton një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitë e varësisë për të mbështetur deklaratën sipas këtij ligji.

3. Ministri përgjegjës për financat miraton dhe i paraqet Këshillit të Ministrave dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit brenda muajit qershor të çdo viti raportin vjetor për cilësinë dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm financiar publik për vitin paraardhës, përfshirë edhe gjetjet e rekomandimet për përmirësimin e sistemit.”.

Neni 11

Në nenet 19, 20, 22, 23 dhe 24 fjalët “titullarët e njësive publike” zëvendësohen me fjalët “ njësitë publike”.

Neni 12

Pika 2 e nenit 21 ndryshohet si më poshtë:

“2. Për t’i zbatuar aktivitetet e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, njësitë publike miratojnë planet e menaxhimit për trajtimin e risqeve, të cilat përditësohen çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut të paktën një herë në vit.”.

Neni 13

Në nenin 25 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 fjalët “sipas nenit 3 të këtij ligji” zëvendësohen me fjalët “sipas nenit 6 të këtij ligji”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Titullarët e njësive publike u sigurojnë punonjësve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar, kontrollit dhe kontabilitetit akses të plotë në dokumentacion, regjistra apo informacione të tjera të nevojshme vetëm për qëllimin e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar, kontrollit dhe kontabilitetit nuk ka si përgjegjësi kryerjen e auditimeve apo të inspektimeve financiare.”.

Neni 14

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

Roli i strukturës përgjegjëse të harmonizimit për menaxhimin financiar, kontrollin dhe kontabilitetin

1. Struktura përgjegjëse e harmonizimit për menaxhimin financiar, kontrollin dhe kontabilitetin në ministrinë përgjegjëse për financat është përgjegjëse për:

a) përgatitjen e ligjeve, të udhëzimeve, të urdhrave dhe të manualeve për fushën e menaxhimit financiar, kontrollit dhe raportimit financiar, për atë që ndodh brenda fushës së saj të përgjegjësisë;

b) përgatitjen, shpërndarjen, përditësimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të strategjive dhe të udhëzimeve metodologjike për menaxhimin financiar e kontrollin dhe kontabilitetin në sektorin publik në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranura për kontrollin e brendshëm dhe kontabilitetin në sektorin publik, rregulloret e zbatueshme dhe praktikën e mira të Bashkimit Evropian;

c) përcaktimin e nevojave dhe udhëheqjen e asistencës, trajnimeve dhe trajnimeve të vijueshme në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përgjegjshmërisë menaxheriale dhe kontabilitetit në njësitë publike;

ç) bashkërendimin e punës për ngritjen dhe zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik;

d) ndërgjegjësimin për kontrollin e brendshëm financiar publik me anë të seminareve dhe publikimeve në faqen e internetit të ministrisë përgjegjëse për financat;

dh) shqyrtimin dhe dhënien e mendimeve për të gjitha projektligjet dhe projektaktet nënligjore, rregulluese, të cilat përmbajnë dispozita për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe raportimin financiar në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse;

e) bashkëpunimin dhe koordinimin e veprimtarisë me institucionet e tjera për hartimin dhe miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e raportimit financiar të sektorit privat.

2. Struktura përgjegjëse e harmonizimit për menaxhimin financiar, kontrollin dhe kontabilitetin siguron vlerësimin e cilësisë në mënyrë sistematike për sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe shoqëritë tregtare sipas përcaktimeve të nenit 3 të këtij ligji, me qëllim mbledhjen e informacionit për të përmirësuar metodologjinë dhe standardet e punës.

3. Vlerësimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe ndjekja e rekomandimeve të lëna nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar, kontrollit dhe kontabilitetit janë të detyrueshme për të gjitha njësitë publike. Mosrespektimi i kërkesave të procesit të vlerësimit të cilësisë ngarkon me përgjegjësi nëpunësin autorizues ose të deleguarin e tij, të cilët bëhen subjekt i masave disiplinore sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

4. Struktura përgjegjëse e harmonizimit për menaxhimin financiar, kontrollin dhe kontabilitetin ndihmon nëpunësin e parë autorizues dhe ministrin përgjegjës për financat për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së sistemit të menaxhimit financiar e kontrollit dhe për përgatitjen e raportit vjetor për cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik, ku përmbledhet informacioni i marrë, në përputhje me dispozitat e nenit 18 të këtij ligji.”.

Neni 15

Pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 28 ndryshohen si më poshtë:

1. Në ministrinë përgjegjëse për financat ngrihet Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, si një organ këshillimor për çështjet që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm në sektorin publik.

2. Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik përbëhet nga ministri përgjegjës për financat, në cilësinë e kryetarit të këtij bordi, nëpunësi i parë autorizues, drejtuesi i strukturës përgjegjëse për kontrollin e brendshëm financiar publik, drejtuesi i strukturës përgjegjëse të buxhetit, drejtuesi i strukturës përgjegjëse për thesarin. Bordi mbledhet të paktën një herë në vit.

3. Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik mund të thërrasë ekspertë të jashtëm me përvojë në fushën e kontrollit të brendshëm financiar publik sipas çështjeve që vendosen të trajtohen, të cilat fokusohen në nevojën për ndryshim të bazës rregullative të fushës së kontrollit të brendshëm, shqyrtim dhe dhënie rekomandimesh për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm në bazë të gjetjeve në raportin vjetor për cilësinë e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik.”.

Neni 16

Nenet 29 dhe 30 shfuqizohen.

Neni 17

Neni 31 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 31

Masa disiplinore dhe masa të tjera

1 Mosrespektimi nga titullari i njësive publike i kërkesave të neneve 8, pika 8, shkronjat “a”, “b”, “ç” dhe “e”, dhe 18, pika 1, të këtij ligji përbën rast të rëndë të mosfunksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësinë publike.

2. Mosrespektimi nga nëpunësi autorizues ose të deleguarit e tij i kompetencave të përmendura në nenet 9, pika 5, 18, pika 1, dhe 26, pika 3, të këtij ligji, si dhe bazuar në rezultatet e vlerësimit të cilësisë për sistemin e kontrollit të brendshëm përbën rast të keqmenaxhimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe ndaj tij ose të deleguarit të tij fillojnë procedurat disiplinore sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, me propozim të nëpunësit të parë autorizues.

3. Ministri përgjegjës për financat për rastet e përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni njofton organet e prapë sipas hierarkisë.

4. Ndaj nëpunësit zbatues dhe menaxherëve të tjerë, të cilët nuk respektojnë përgjegjësitë e parashikuara nga nenet 11 dhe 12, pika 1, të këtij ligji, si dhe bazuar në rezultatet e vlerësimit të cilësisë për sistemin e kontrollit të brendshëm, fillojnë procedurat disiplinore, me propozimin e nëpunësit autorizues të njësive publike ose të nëpunësit të parë autorizues.”.

Neni 18

Dispozitë kalimtare

Kriteret e përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji për punonjësit në detyrë do të përmbushen brenda një periudhe kalimtare trevjeçare.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratur në datën 16.2.2023.

Shpallur me dekretin nr. 36, datë 2.3.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.